

VENDIM
Nr. 977, datë 25.10.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË TAJLANDËS, PËR
PËRJASHTIMIN NGA VIZAT PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË
SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Tajlandës, për përjashtimin nga vizat për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
MBRETËRISË SË TAJLANDËS MBI HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Mbretërisë së Tajlandës (referuar më poshtë si “Palët”),

Nisur nga dëshira për të lehtësuar hyrjen, daljen dhe lëvizjen pa viza të qytetarëve të tyre, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

1. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Republikës së Shqipërisë nuk do të paraqesin kërkesa për hyrje, dalje, kalim transit ose qëndrim në Mbretërinë e Tajlandës për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e hyrjes së tyre, me kusht që ata nuk do të merren me ndonjë veprimtari, qoftë vetëpunësim ose me ndonjë aktivitet tjetër privat në Mbretërinë e Tajlandës.

2. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Mbretërisë së Tajlandës nuk do të kenë nevojë për vizë për hyrje, dalje, kalim transit ose qëndrim në Republikën e Shqipërisë për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e hyrjes së tyre, me kusht që ata nuk do të merren me ndonjë veprimtari, qoftë vetëpunësim ose me ndonjë aktivitet tjetër privat në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

1. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Mbretërisë së Tajlandës, që janë në përbërje të misioneve diplomatike ose konsullore të Mbretërisë së Tajlandës, ose janë përfaqësues të Mbretërisë së Tajlandës në ndonjë organizatë ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Mbretërisë së Tajlandës, mund të hyjnë, të qëndrojnë dhe të largohen nga Republika e Shqipërisë pa marrë viza për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë. Periudha të tilla, me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Tajlandës ose të Ambasadës së Tajlandës në Romë, mund të zgjatet deri në fund të detyrës së tyre.

2. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Republikës së Shqipërisë, që

janë në përbërje të misioneve diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë ose janë përfaqësues të Republikës së Shqipërisë në ndonjë organizatë ndërkombëtare në Mbretërinë e Tajlandës, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Republikës së Shqipërisë, mund të hyjnë, të qëndrojnë dhe të largohen nga Mbretëria e Tajlandës pa marrë viza për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë. Periudha të tilla, me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë ose të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Kuala Lumpur, mund të zgjaten deri në fund të detyrës së tyre.

Neni 3

Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit, që u jepet e drejta të përjashtohen nga vizat sipas dispozitave të nenit 1 dhe 2 të marrëveshjes, mund të hyjnë, largohen ose kalojnë transit në territorin e Palës tjetër në çdo vendkalim kufitar të caktuar për trafikun ndërkombëtar, me kusht që ata të respektojnë ligjet dhe rregullat e palëve përkatëse që rregullojnë hyrjen, udhëtimin dhe qëndrimin e të huajve.

Neni 4

1. Mbajtësit e pasaportave diplomatike apo të shërbimit do të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e palës tjetër gjatë qëndrimit në territorin e asaj Pale.

2. Kjo marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve për të refuzuar hyrjen ose të anulojë qëndrimin për një qytetar të Palës tjetër, të cilin ajo e konsideron një *person non grata*.

Neni 5

1. Me synimin për të mbrojtur sigurinë kombëtare, rendin dhe qetësinë publike, dhe shëndetin e qytetarëve të tyre, secila Palë mund të pezullojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje pjesërisht ose plotësisht.

2. Palët do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për zbatimin ose anulimin e një mase të tillë nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 6

1. Palët do të shkëmbejnë specimenet e pasaportave të tyre përkatëse të vlefshme diplomatike dhe shërbimi, të paktën 30 ditë para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Në rastin e futjes në qarkullim nga secila Palë e pasaportave të reja diplomatike apo shërbimi, secila Palë do të njohë Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike me specimenet e pasaportave të reja, të paktën 30 ditë para nxjerrjes së tyre në qarkullim.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht me konsultime apo negociata midis Palëve.

Neni 8

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë nga data e njoftimit të fundit me shkrim nga Palët të përfundimit të procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund ta anulojë këtë marrëveshje në çdo kohë, duke i dërguar njoftim me shkrim Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Anulimi do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë nga data e marrjes së këtij njoftimi nga ana e Palës tjetër.

3. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo modifikohet me marrëveshje të përbashkët me shkrim të Palëve.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar për këtë rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, e kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Nju-Jork, më 27 shtator 2013, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.